

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“AUTO MECO” Sh.p.k.**

Soç, më date **04.12.2024**, ne te nenshkruarit:

- **Enea Meço** lindur me 01/04/1989, shtetas shqiptar, banues ne Lushnje, identifikuar me nr. personl 190401130P, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar..
- **Z. Frenki Meço** shtetas shqiptar, i datlindjes 11/09/2001, banues ne Lushnje, identifikuar me nr. Personal K10911098N, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.; në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare” kemi vendosur të themelojme një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar **“AUTO MECO” Sh.p.k.** (më poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi dhe i bashkëngjitet si Shtojca 1.

**Neni 1**

Emri i Shoqërisë është: **“AUTO MECO” Sh.p.k**

**Neni 2**

(1) Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Lushnje Lagjja Gafurr Muço, rruga Sulejman Delvina, godine 1 kateshe me Nr. pasurie 13/92, Z.K. 8572, vol 19, faqe 32..

(2) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: [eneameco505@gmail.com](mailto:eneameco505@gmail.com)  
Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë.

**Neni 3**

- Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë 10 vjet dhe fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

**Objekti i veprimtarise se shoqerise**

**Neni 4**

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm :

- Import dhe tregtim te autovegurave te perdorura. Dhenie autovegurave me qera, Transport mallrash te ndryshme per te trete etj.
- Megjithate shoqëria ka te drejte qe te shtoje dhe te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj me vendim te asamblese se ortakeve.

**Neni 5**

**Kapitali themeltar**



(1)Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 3 000 000 (Tre milion) leke. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues Enea Meço: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej 1 500 000 leke që përbën 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortaku themelues Frenki Meço: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej 1 500 000 leke që përbën 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve do të jetë në para .

Kontributi i ortakëve do të jetë në para .

**Neni 6:**

### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Shtimi ose pakesimi i kapitalit themelor mund te behet vetem pasi Asamblea e ortakëve me shumice e ka dekretuar kete dhe per me teper te gjithe ortakët jane te detyruar qe ta repektojnë dhe te kontribuojne ne para ose ne natyre ne baze te vendimit te shumices se asamblese

**Neni 7:**

### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit te një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e te drejtat që rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen pëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) shitblerjes;(me te drejten e parablerjes nga ana e ortakëve).
- c) trashëgimise;
- d) dhurimit;
- e) cdo menyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjerisht të trasferueshme ndërmjet ortakëve,përsa nuk parashikohet ndryshe në statur.

Pjesët e kapitakit themeltare janë ligjerisht të trasferueshme me rrugë trashgimnie.

**Neni 8**

### **Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakëve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi, marrja e vendimeve ,përfundimi nga e drejta e votës dhe te tjera modalitete per funksionimin e organit vendimarrës përcaktohen ne statutin e shoqërisë.

#### **Neni 9**

##### **Administrimi**

Aministratori i shoqërisë emërohet Z. **Enea Meço** lindur me 01/04/1989,shtetas shqiptar,banues ne Lushnje, identifikuar me nr. personl I90401130P,madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar. i zgjedhur per nje periudhe 5 vjecare me te drejte rizgjedhje..

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratorit janë të përcaktuara qartë ne statutin e shoqërisë.

#### **Neni 10**

##### **Viti financiar-ekspertët**

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxierien e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cialt është i detyruar që tja paraqesë e ta dorëzojë në kohë ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

#### **Neni 11**

##### **Prishja-riorganizimi i shoqërisë**

Modalitetet per prishjen dhe riorganizimin e shoqërisë janë të përcaktuara ne statutin e shoqërisë në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

#### **Neni 12**

Akti i Themelimit është hartuar ne 4 kopje origjinale.

### **ORTAKET E SHOQËRISË**

**Enea Meço**

**Frenki Meço**